V E N D I M
Nr.338, datë 23.5.2001

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI, NË FAVOR TË KISHËS KATOLIKE SHQIPTARE, MBI TË CILËN DO TË NDËRTOHEN KOMPLEKSI UNIVERSITAR "UNIVERSITETI KATOLIK" DHE "QENDRA E REHABILITIMIT DHE E MJEKËSISË SPORTIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në pronësi të Kishës Katolike Shqiptare të një sipërfaqeje trualli prej 49 453 m2, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, mbi të cilën do të ndërtohen kompleksi universitar "Universiteti Katolik" dhe "Qendra e Rehabilitimit dhe e Mjekësisë Sportive".

2. Koeficienti i përllogaritjes së çmimit të shitjes së truallit të jetë 0.001.

3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së këtij trualli.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

E = 39940000

Planvendosja e "Universitetit katolik" dhe "Qendrës së rehabilitimit dhe mjekësisë sportive"
Shk. 1 : 2000



Nr.License T0041/3

TIRANE 25 Prill 2001